

VENDIM
Nr. 676, datë 6.12.2023

PËR NJË SHITESË DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 770, DATË 15.12.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË SHKOLLËS 9-VJEÇARE ‘DEMOKRACIA’, VALIAS I RI, BASHKIA KAMZË, DHE ÇAKTIMIN E BASHKISË KAMZË SI NJËSI ZBATUESE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 770, datë 15.12.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar bëhen shtesa dhe ndryshimi, si më poshtë vijon:

a) Pas pikës 2/1 shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

“2/2. Bashkisë Kamzë, në buxhetin e vitit 2023, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 207 216 918 (dyqind e shtatë milionë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare “Demokracia”, Valias i Ri, Bashkia Kamzë, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023.”.

b) Në pikën 3, fjalët “... sipas pikave 1, 2 dhe 2/1...” zëvendësohen me “... sipas pikave 1, 2, 2/1 dhe 2/2 ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku